



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË PËR KRIMET E RËNDA

NR. AKTIT 115

NR. VENDIMIT 276

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda e përbërë nga:

Laurent FUÇIA	(K/Seancës)
Engert PËLLUMBI	(Anëtar)
Igerta BENGU	(Anëtare)
Arta BURDA	(Anëtare)
Eloida GOXHI	(Anëtare)

Me sekretare gjyqësore **Eva Cepa**, në Tiranë, sot më datë 10.5.2010, mori në shqyrtim çështjen me nr. 115 të aktit, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, përfaqësuar nga prokurorët Arben Smaçi dhe Albert Kuliçi, me autorizim.

TË PANDEHUR: 1. Florjan Kalaja, i biri i Maksutit dhe i Selvijes, i datëlindjes 15.11.1980, lindur dhe banues ne Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dënuar më parë nga gjykatat italiane, me arsim të lartë, gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”, përfaqësuar në gjykim nga avokatët Joana Qelesi dhe Arbër Çela, me deklaram.

2. Arbër Berexha, i biri i Besnikut dhe i Vjollcës, i datëlindjes 15.12.1982, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dënuar më parë nga gjykatat italiane, me arsim të lartë, gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”, përfaqësuar ne gjykim nga avokatët Joana Qeleshi dhe Arbër Çela, me deklaram.

AKUZUAR: Për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan:

- Organi i akuzës – deklaramin fajtor të të pandehurit Florjan Kalaja, për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim si dhe 8 000 000 (tetëmilion) lekë gjobë; deklaramin fajtor të të pandehurit Arbër Berexha, për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 21 (njëzetënjë) vjet burgim si dhe 8 000 000 (tetëmilion) lekë gjobë.
- Mbrojtësit e të pandehurve – pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak se ndjekja penale nuk duhej të fillonte dhe nuk duhet të vazhdojë.
- Të pandehurit – pafajsi;

VËREN

I

1. Se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka paraqitur më datë 17.4.2010, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kërkesën për gjykim, në ngarkim të të pandehurve Florjan Kalaja dhe Arbër Berexha, akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal.

2. Nga materialet që ndodhen në dosjen gjyqësore rezultuan të provuara faktet si më poshtë:

2.1. E ndjera Rina Mema është martuar me të pandehurin Arbër Berexha më datë 10.5.2008.

2.2. E dëmtuara Pranvera Hoxha është e dashuara e të pandehurit Florjan Kalaja dhe kanë bashkëjetuar nga data 10.9.2008 deri më datë 10.6.2009.

2.3. Të pandehurit Florjan Kalaja dhe Arbër Berexha janë shokë që prej vitit 2007, pasi kanë mbaruar shkollën e lartë së bashku.

2.4. Të pandehurit në bashkëpunim me njëri – tjetrin kanë vedosur që të dëmtuarat t'i trafikojnë në Itali me qëllim shfrytëzimin e tyre për prostitucion.

2.5 Për këtë qëllim i pandehuri Arbër Berexha ka lidhur martesë fiktive me të ndjerën Rina Mema.

2.6. Ky i pandehur është paraqitur pranë familjes së të ndjerës Rina Mema si person që jeton në Itali me dokumenta të rregullta. Pas martesës i pandehuri Arbër ka kërkuar nga kjo e fundit që të shkojnë në Itali pasi në Shqipëri është vështirë për të gjetur punë si dhe me qëllimin për të krijuar familje. I pandehuri i ka treguar të ndjerës se nga Italia do të vinte një shok i cili do t'u gjente punë dhe strehim në Itali. Për qëllimin e ikjes në Itali është njoftuar edhe familja e saj.

2.7. Për të realizuar ikjen në Itali, i pandehuri ka siguruar një vizë të rregullt për bashkëshorten e tij.

2.8. I pandehuri Florjan Kalaja ka ardhur në Shqipëri më datën 7.7.2008, me qëllim që së bashku me të pandehurin Arbër Berexha, të trafikojnë bashkëshorten e këtij të fundit drejt Italisë.

2.9. Gjatë qëndrimit në Shqipëri i pandehuri Florjan Kalaja është njohur me të dëmtuarën Pranvera Hoxha. Duke përfituar nga gjendja e vështirë ekonomike e të dëmtuarës, i pandehuri Florjan i ka premtuar se do ta marrë me vete në Itali.

2.10. Të pandehurit, në marrëveshje ndërmjet tyre, kanë ranë dakort për të trafikuar edhe të dëmtuarën Pranvera Hoxha. Për këtë qëllim ata siguruan dy viza të rregullta, pasi që të dy dispononin dokumenta italiane.

2.11. I pandehuri Arbër Berexha, një natë para se të niseshin për në Itali, fton për darkë të pandehurin Florjan dhe të dëmtuarën Pranvera Hoxha. Gjatë darkës të dëmtuarat marrin dijeni se të nesërmen do të niseshin drejt Italisë.

2.12. Më datë 5.1.2009, ora 09:00, të pandehurit, së bashku me të dëmtuarat, janë nisur nga aeroporti i Rinasit dhe kanë mbërritur në Milano të Italisë rreth orës 10:30. Pas mbërritjes në Itali, dy të dëmtuarat janë sistemuar në shtëpinë e të pandehurit Florjan Kalaja, deri më datë 7.1.2009.

2.13. Më datë 9.1.2009 të pandehurit kanë detyruar të dëmtuarat të ushtrojnë prostitucion në lokalin “Fiesta”, në Milano të Italisë, të cilin e kishin marrë me qira këta të fundit. Lokali ishte dy katësh, në katin e parë shërbente si “Club” ndërsa kati i dytë përdorej për shfrytëzim prostitucioni. Të dëmtuarat shërbenin në katin e parë si kamariere dhe kur kishte klientë detyroheshin të ngjiteshin në katin e dytë nga të pandehurit, për të ushtruar prostitucion. Kjo veprimtari ka vazhduar deri më datë 10.6.2009.

2.14. Në këtë datë policia italiane ka zbuluar këtë aktivitet të paligjshëm. Autoritetet e këtij shteti kanë filluar procedimin penal ndaj të pandehurve Florjan Kalaja dhe Arbër Berexha nën akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit.

2.15. Me vendimin nr.123, datë 12.9.2009, gjykata e Milanos i ka dënuar të pandehurit, në mungesë, për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit me 2 (dy) vjet burg secilin.

3. **Mbrojtësit e të pandehurve**, gjatë kërkesave paraprake, kërkuar nga gjykata që çështja penale nuk duhej të kishte filluar dhe për këtë arsye duhet të pushonte, me argumentin se ndodhemi përpara parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale ose i njohur ndryshe si “*ne bis in idem*”, pasi për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtëve persona ishte dhënë vendim fajsie nga gjykata italiane e Milanos.

4. Gjithashtu për të mbështetur pretendimin tjetër të tyre se fakti nuk ekzistonte, ata kërkuar thirrjen dhe pyetjen si dëshmitare të motrës së të pandehurit Florjan Kalaja, shtetasen Riselda Fishta, pyetje e cila u realizua gjatë seancës gjyqësore.

5. **Organi i akuzës**, kërkoi mospranimin e kërkesës së mbrojtësve të të pandehurve për pretendimin e tyre se ndodhemi përpara parimit “*ne bis in idem*”, me arsyetimin se një parim i tillë nuk shtrihet si rregull për veprat penale të gjykuara jashtë shtetit si dhe fakti për të cilin akuzohen të pandehurit nuk është i njëjtë me atë për të cilin janë dënuar nga gjykata e Milanos.

6. Në mbështetje të kërkesës së tyre për gjykim, organi i akuzës paraqiti përpara gjykatës disa prova, nga të cilat me vendim të ndërmjetëm u pranuan dhe u administruan:

- Procesverbali për sigurimin e provës për pyetjen e dëshmitares Rina Mema.
- Akti i ekspertimit psikiatriko – ligjor për të dëmtuarën Pranvera Hoxha.
- Akti i ekspertimit mjeko – ligjor për të dëmtuarën Rina Mema.
- Procesverbali i përgjimeve ambientale ndërmjet të pandehurve Florjan Kalaja dhe Arbër Berexha.
- Pyetja si dëshmitare e të dëmtuarës Pranvera Hoxha (e fiksuar në procesverbalin e seancës gjyqësore).
- Vendimi i formës së prerë i gjykatës së Milanos, me të cilin janë shpallur fajtor në mungesë të pandehurit dhe janë dënuar me nga dy vjet burg secili.

II

A. Në lidhje me parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (ne bis in idem).

7. Përpara se të përcaktojë nëse ndodhemi përpara parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale në lidhje me çështjen që po shqyrtohet, gjykata çmon të nevojshme të japë fillimisht kuptimin e këtij parimi si dhe zbatimin e tij në hapsirë (ratione loci).

8. Parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (që këtu e në vijim “*ne bis in idem*”) është një nga elementët përbërës të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke u parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 4 i Protokollit 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (K.E.D.NJ). Ky parim, duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë dhe duke qënë në të njëjtën kohë garant i parimit tjetër kushtetues të sigurisë juridike, ndalon gjykimin dhe dënimin dy herë, ndaj të njëjtit personi, bazuar në të njëjtin fakt, kur gjykimi i parë ndaj tij ka përfunduar me vendim të formës së prerë të gjykatave. I vetmi përjashtim që parashikohet në kushtetutë, konventë dhe ligj është rasti kur vendoset rigjykimi si pasojë e shkakut se kanë dalë apo janë zbuluar rrethana të reja të cilat e bëjnë të cënueshëm

vendimin ose kur janë vërejtur shkelje procedurale nga gjykatat më të ulta në raport me gjykatën që vendos për rigjykimin e çështjes.

9. Elementët kyç të cilët bëjnë të nevojshëm zbatimin e këtij parimi, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personit të gjykuar më parë, janë së pari, ekzistenca e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, në bazë të të cilit personi është shpallur fajtor dhe dënuar ose shpallur i pafajshëm dhe së dyti, gjykimi i ri të bazohet mbi të njëjtin fakt kriminal. Me të njëjtin fakt kriminal do të kuptojmë të njëjtat veprime ose mosveprime, që synojnë të njëjtën pasojë kriminale, cënimin e marrëdhënieve juridike të rëndësishme, të mbrojtura nga legjislacioni penal, veprime ose mosveprime këto të kryera nga i njëjti subjekt.

10. Nga vendimi penal i gjykatës së Milanos, administruar si provë në fashikullin gjyqësor, gjykata konstaton se të pandehurit janë deklaruar fajtorë dhe dënuar nga ana e shtetit italian për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese (bazuar në nenet 3, 4, 7 dhe 8 të “Ligjit Merlin”).

11. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, të pandehurit janë sjellë për gjykim me akuzën e “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal. Mbrojtësit e të pandehurve që gjatë fazës së hetimeve paraprake por edhe në gjykim kanë pretenduar se ndodhemi përpara të njëjtit fakt kriminal, pretendim i cili nuk është konsideruar i drejtë nga ana e organit të akuzës.

12. Në lidhje me pretendimin e mësipërm, të ngritur nga ana e mbrojtësve të të pandehurve, gjykata vlerëson se bazuar në rrethanat konkrete të çështjes, ndodhemi përpara të njëjtit fakt kriminal. E gjithë veprimtaria kriminale e të pandehurve me qëllim shfrytëzimin e të dëmtuarave për prostitucion në shtetin italian ka qënë unike dhe e mbështetur në një qëllim të vetëm kriminal. Kështu siç ka rezultuar nga të dhënat e ndodhura në fashikullin e gjykimit, të pandehurit duke mashtruar të dëmtuarat me qëllimin për një jetë më të mirë, kanë arritur t’i rekrutojnë dhe transportojnë ato drejt Italisë ku më pas i kanë shfrytëzuar për qëllime prostitucioni. Edhe pse në vendimin e gjykatës së Milanos të pandehurit janë dënuar vetëm për veprimet e kryera në shtetin italian, e gjithë veprimtaria e tyre synonte në realizimin e të njëjtit dhe të vetmit qëllim kriminal, shfrytëzimit të të dëmtuarave për prostitucion. Neni 114/b i Kodit Penal është

një dispozitë përshkruese, e cila nga ana objektive, kryerjen e veprës penale të trafikimit të femrave e parashikon në një sërë formash ndër të cilat edhe rekrutimi e transportimi, forma të cilat në fund të fundit kanë për qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.. Duke qënë një veprë penale materiale, trafikimi i femrave nuk quhet i konsumuar vetëm me kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve përkatëse pa qënë këto të fundit të lidhura me qëllimin kriminal, shfrytëzimin e të dëmtuarave nga kjo veprë penale për qëllim prostitucioni ose formave të tjera të shfrytëzimit. Veprimet e kryera për rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e femrave do të qëndronin si një veprë penale më vete, të shkëputura nga shfrytëzimi i tyre, vetëm nëse aktiviteti i shfrytëzimit do të realizohej nga persona të tjerë, të ndryshëm nga ata që kanë realizuar veprimet e mësipërme në territorin shqiptar. Ndodhur në kushtet kur e gjithë veprimtaria e kundërligjshme është kryer nga të pandehurit me një qëllim të vetëm, shfrytëzimin e të dëmtuarave për prostitucion, gjykata nuk e gjen të bazuar në ligj pretendimin e organit të akuzës për kualifikimin si një veprë penale më vete të veprimeve të kryera nga të pandehurit në territorin e shtetit shqiptar.

13. Për zbatimin në hapsirë (ratione loci) të parimit “*ne bis in idem*”, gjykata konsideron të domosdoshme analizimin e dispozitave përkatëse që lidhen me këtë parim në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Protokolli 7), dispozitat e Kodit të Procedurës Penale si dhe Konventën Evropiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykrimeve Penale, datë 28.5.1970, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003.

14. Kushtetuta në nenin 34 parashikon se: “*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj*”. Nga ky formulim i dispozitës nuk merret ndonjë informacion në lidhje me zbatimin e parimit “*ne bis in idem*” për veprat penale të gjykuara jashtë vendit, me përjashtim të pjesës së dytë të fjalisë e cila bën fjalë për kufizimin e këtij parimi kur vendoset rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, çfarë patjetër nënkupton zbatimin

e tij vetëm për ato vepra të gjykuara nga gjykatat shqiptare. Pra kushtetuta e lë të hapur mundësinë e kufizimit të zbatimit të parimit në fjalë në elementin hapsirë.

15. Nga ana tjetër, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si një dokument që vendos standartet dysHEME për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, në neni 4 të Protokollit 7 parashikon: *“Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksionet e të njëjtit Shtet për një veprë për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti”*. Pra K.E.D.NJ – ja është kufizuar për shtrirjen e parimit vetëm brenda juridiksionit të të njëjtit shtet. Megjithatë ashtu siç përcaktohet në nenin 53 të K.E.D.NJ – së: *“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose çënon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo Pale Kontraktuese ose nga çdo konventë tjetër në të cilën kjo Palë Kontraktuese është palë”* si dhe si është theksuar në vazhdimsi nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet palë të kësaj Konvente mund të vendosin standarte më të larta se ato të parashikuara në të.

16. Edhe neni 7 i Kodit të Procedurës Penale përmaban një formulim pothuajse të njëjtë me nenin 34 të Kushtetutës. Megjithatë është titulli X i këtij kodi, *“Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja”*, ai i cili parashikon fuqinë e vendimeve të gjykatave të huaja në territorin shqiptar. Në nenin 512 § II parashikohet se: *“Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t’i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar”*. Nga kjo dispozitë shihet se për t’u shtrirë efekti i parimit *“ne bis in idem”* edhe në lidhje me një vendim të dhënë nga një autoritet i huaj, duhet që fillimisht ky vendim të njihet në shtetin shqiptar, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë. Ndërsa në nenin 514 § I, gërma dh) është parashikuar se vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur: *“për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal”*. Nga këto dispozita del se në rastin në shqyrtim parimi i *“ne bis in idem”* nuk do të gjejë zbatim pasi jo vetëm që vendimi i gjykatës së Milanos nuk është njohur në shtetin tonë, por të njëjtët persona janë duke u gjykuar për të njëjtin fakt në këtë proces gjyqësor.

17. Me rëndësi përcaktuese për këtë parim është Konventa Evropiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, e ratifikuar me ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003, përkatësisht neni 53 i tij, i cili përcakton:

“Një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal evropian, nuk mund të procedohet, gjykohet apo të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur:

- a) Ai është shpallur i pafajshëm;*
- b) Sanksioni i vendosur:*
 - i) Është ekzekutuar plotësisht ose është duke u ekzekutuar;*
 - ii) Është objekt i një faljeje ose amnistie në tëresinë e tij ose për pjesën e paekzekutuar;*
 - iii) Nuk mund të ekzekutohet më, pasi është parashkruar;*
- c) Gjykata konstaton fajësinë e autorit, por nuk vendos asnjë sanksion.*

Sidoqoftë, nje shtet palë nuk është i detyruar, përveçse, kur ai vetë ka kërkuar procedimin, të njohë pasojat e “ne bis in idem”, nëse veprimi që i dha shkas gjykimin është drejtuar kundër ndonjë personi, institucioni ose sendi që ka karakter publik në këtë shtet ose nëse personi objekt i gjykimin kishte një karakter publik në këtë shtet.

3. Gjithashtu, çdo shtet palë në të cilin është kryer veprimi ose është konsideruar i tillë në përputhje me legjislacionin e atij shteti, nuk është i detyruar të njohë pasojat e “ne bis in idem” përveçse, kur ky shtet ka kërkuar procedimin.”.

18. Siç shihet nga dispozita e kësaj konvente, në rastin e të pandehurve nuk ndodhemi në asnjë nga përjashtimet e parashikuara në të. Gjithashtu rregullat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, siç u përmendën, nuk parashikojnë zbatim më të gjerë të këtij parimi, sikurse lejon neni 55 i Konventës së sipërcituar, i cili shprehet: *“Ky seksion nuk pengon zbatimin e rregullave kombëtare më të gjera lidhur me pasojat e Ne Bis In Idem për gjykimet penale të huaja.”.*

19. Si përfundim, për sa u arsyetua, nuk ndodhemi përpara parimit të *“ne bis in idem”*.

B. Në lidhje me fajsinë e të pandehurve.

20. Gjykata çmon se nga ana e organit të akuzës u arrit të provohej veprimtaria kriminale e të pandehurve për trafikimin e të dëmtuarave, me qëllim shfytëzimin e tyre për prostitucion.

21. Nëpërmjet deklarimeve të dhëna në gjykim nga e dëmtuara Pranvera Hoxha, procesverbali i sigurimit të provës për pyetjen si dëshmitare të të ndjerës Rina Mema si dhe procesverbali i përgjimeve ambientale ndërmjet të pandehurve, ka rezultuar i provuar qëllimi i tyre për trafikimin e të dëmtuarave në drejtim të Italisë.

22. Veprimtaria e kryer nga të pandehurit në territorin shqiptar konfirmohet nga faktet e provuara në gjykim, fakte të cilët paraqesin dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve si dhe mendimin kriminal të të pandehurve për trafikimin e të dëmtuarave (shih paragrafët 2.4 – 2.12).

23. Për sa i përket veprimtarisë së mëtejshme, të realizuar nga këta të pandehur në shtetin italian, përveç provave të sipërpërmendura, konfirmohet edhe nga vendimi nr.123, datë 12.9.2009, i gjykatës së Milanos, me të cilin këta të pandehur janë dënuar në mungesë për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese si dhe aktet e ekspertimit psikiatriko – ligjor për të dëmtuarën Pranvera Hoxha si dhe akti i ekspertimit mjeko – ligjor për të ndjerën Rina Mema (shih paragrafët 2.12 – 2.15).

24. Në lidhje me provën e kërkuar nga mbrojtësit e të pandehurve dhe të pranuar nga gjykata, pyetjen e dëshmitares Riselda Fishta, gjykata i vlerëson me rezervë deklaratimet e kësaj dëshmitareje, nisur nga fakti se kjo e fundit është motra e të pandehurit Florjan Kalaja si dhe duke pasur parasysh se një pjesë të të dhënave që ajo dëshmoi në gjykim i ka marrë nga komunikimet telefonike me të pandehurin Florjan si dhe të dëmtuarën Pranvera Hoxha, në kohën që këta të fundit ndodheshin në Itali.

25. Për sa më sipër gjykata vlerëson se janë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Trafikimit të femrave”, veprë kjo e kryer në bashkëpunim nga të pandehurit, sipas paragrafit të tretë të nenit 114 të Kodit Penal.

25.1. Së pari, janë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen e moralit, dinjitetit si dhe lirisë e paprekshmërisë seksuale nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

25.2. Së dyti, veprimet kriminale janë kryer në formën e rekrutimit dhe transportimit, përmes mashtrimit të të dëmtuarave, në drejtim të Italisë, për t'u shfrytëzuar më pas nën detyrimin e dhunës fizike dhe psikike për ushtrimin e veprimtarisë së prostitucionit.

25.3. Së treti, veprimtaria kriminale është kryer me dashje direkte në formën e paramendimit (*dolus praemeditatus*) dhe me qëllim shfrytëzimin e të dëmtuarave për prostitucion, veprimtari e kryer në bashkëpunim nga të pandehurit.

25.4. Së katërti, të pandehurit janë nga ata subjekte që mbajnë përgjegjësi penale për veprën për të cilën akuzohen pasi kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm.

26. Në këto rrethana gjykata arrin në konkluzionin se të dy të pandehurit duhet të shpallen fajtorë për veprën penale të "Trafikimit të femrave", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal.

C. Në lidhje me llojin dhe masën së dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurve.

27. Së pari, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurit, gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e veprës së kryer prej tyre. Veprimtaria e tyre kriminale ishte paramenduar dhe planifikuar me kujdes, kohë më parë se të realizohej. Një konkluzion i tillë provohet nga faktet se të pandehurit erdhën në Shqipëri pikërisht me qëllimin e trafikimit, fillisht të të dëmtuarës Rina Mema e më pas edhe të të dëmtuarës tjetër Pranvera Hoxha. I gjithë aktiviteti i tyre, duke filluar që nga mashtrimi i të dëmtuarave dhe deri tek sigurimi i vizave të rregullta për në Itali madje dhe marrja me qira e lokalit në qytetin e Milanos për shfrytëzimin e të dëmtuarave për prostitucion, dëshmon për rrezikshmërinë e lartë të veprës së kryer nga të pandehurit. Gjithashtu gjykata konsideron këtu edhe pasojat që vepra ka shkaktuar ndaj të dëmtuarave, e provuar me aktet e ekspertimit.

28. Së dyti, nga gjykata mbahet parasysh edhe rrezikshmëria e autorëve të veprës penale, fakti se ata nuk janë dënuar më parë për vepra penale të tjera.

29. Në mënyrë të veçantë, për të pandehurin Arbër Berexha, gjykata mban në konsideratë se ky i pandehur ka trafikuar bashkëshorten e tij, të ndjerën Rina Mema, me të cilën kishte lidhur martesë më datë 10.5.2008.

30. Në këto rrethana, gjykata vlerëson se për të pandehurin Florjan Kalaja duhet të caktohet dënimi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim si dhe 6 000 000 (gjashtëmilion) lekë gjobë, ndërsa për të pandehurin Arbër Berexha dënimi me 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet burgim si dhe 6 000 000 (gjashtëmilion) lekë gjobë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Gjykata bazuar në nenet 390 dhe 393 të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Florjan Kalaja për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal dhe dënimin e tij, bazuar në këtë nen, me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim si dhe 6 000 000 (gjashtëmilion) lekë gjobë.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Arbër Berexha për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 114/b § III i Kodit Penal dhe dënimin e tij, bazuar në këtë nen, me 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet burgim si dhe 6 000 000 (gjashtëmilion) lekë gjobë.
- Vuajtja e dënimit nga të pandehurit fillon nga data e arrestimit të tyre, më 16.2.2010.
- Vuajtja e dënimit do të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.
- Shpenzimet gjyqësore në shumën prej 60 000 (gjashtëdhjetëmijë) lekësh i ngarkohen të pandehurve solidarisht.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda dhjetë ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij, në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.
- U shpall sot, në Tiranë, më 10.05.2010.

Laurent FUÇIA
Kryetar

Engert PËLLUMBI
Anëtar

Igerta BENGU
Anëtare

Arta BURDA
Anëtare

Eloida GOXHI
Anëtare

MENDIM PARALEL

1. Jam dakord me vendimin e marrë nga shumica në lidhje me fajsinë e të pandehurve, me llojin dhe masën e dënimit si dhe me konkluzionin se nuk ndodhemi përpara mosgjyqimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) por nuk jam dakord me arsyetimin e shumicës në bazë të së cilës ata arrijnë në këtë përfundim.

2. Në fazën e kërkesave paraprake, nga avokatët e të pandehurve Florjan Kalaja dhe Arbër Berexha, u pretendua pushimi çështjes penale në ngarkim të tyre, konform nenit 387, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se ndodhemi përpara gjyqimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*), e për pasojë ndjekja penale ndaj tyre nuk mund të fillonte, e nëse kishte filluar duhej pushuar.

3. Pala akuzuese e kundërshtoi këtë kërkesë të palës mbrojtëse, me argumentin se parimi i “*ne bis in idem*”, sipas nenit 4 të Protokollit 7 të K.E.D.NJ vlen vetëm brenda juridiksionit gjyqësor të një shteti palë. Gjithashtu pala akuzuese argumentoi se parimi i “*ne bis in idem*” në rastin konkret nuk bie brenda aplikimit të nenit 53, pika 1 të Konventës Evropiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale si dhe fakti se të pandehurit janë akuzuar për një vepër penale të kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, vepër e cila është e ndryshme nga ajo për të cilën ata janë dënuar në shtetin italian.

4. Në vijim të arsyetimit tim i cili është i kundërt me atë të shumicës, çmoj se ka rëndësi esenciale zberthimi i elementëve përbërës të parimit “*ne bis in idem*”.

5. Parimi “*ne bis in idem*”, i cili fjalë për fjalë do të thotë “*jo dy herë për të njëjtën gjë*”, parashikohet shprehimisht në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 4 të Protokollit 7 të K.E.D.NJ – së si dhe në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale, si pjesë esenciale e të drejtave dhe lirive themelore të individit, cënim i së cilës do të sillte ekzistencën e një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të K.E.D.NJ dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

6. Nga interpretimi logjik, gramatikor dhe literal i nenit 34 të Kushtetutës, nenit 4 të Protokollit 7 të K.E.D.NJ, nenit 53 të Konventës Evropiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale dhe nenit 7 të K. Pr. Penale, arrijmë në konkluzionin se që të ndodhemi përpara aplikimit të parimit të “*ne bis in idem*”, duhet të

plotësohen në mënyrë kumulative këto elemente: a) personi të jetë gjykuar më parë, b) ndaj tij të jetë dhënë një vendim penal përfundimtar, c) ky vendim të jetë dhënë për të njëjtën vepër penale për të cilën ai po gjykohet. Nga një interpretim në të kundërt (ad contrario), arrijmë në konkluzionin se nuk ndodhemi përpara parimit të “*ne bis in idem*”, nëse një person është gjykuar më parë për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën ai po gjykohet.

7. Sipas parimit të ligjshmërisë (nullum crimen, nulla poena sine lege) veprat penale dhe dënimet për to duhet të jenë të parashikuara shprehimisht në ligj. Kjo do të thotë se çdo person do të mbajë përgjegjësi penale vetëm për ato veprime apo mosveprime, që sipas ligjit penal, përbëjnë vepër penale. Por përgjegjësia penale lidhet me veprimin në kohë (ratione temporae) dhe hapsirë (ratione loci) të ligjit penal. Nga interpretimi sistematik i neneve 5, 6, dhe 7 të Kodit Penal, arrijmë në konkluzionin se Kodi ynë Penal ka pranuar parimin e territorialitetit, sipas të cilit çdo person që kryen një vepër penale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht shtetësisë së tij, do të përgjigjet sipas ligjit penal shqiptar.

8. Ky parim lidhet ngushtë me parimin e sovranitetit territorial brenda të cilit ushtrohet pushteti shtetëror, e konkretisht ushtrimi i ndjekjes penale dhe dhënia e drejtësisë.

9. Në çështjen penale objekt gjykimi, të pandehurit, përmes veprimeve që konsistojnë në rekrutimin dhe transportimin përmes mashtrimit, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të dëmtuarave, kanë konsumuar figurën e krimit të “Trafikimit të femrave” (neni 114/b/3 i Kodit Penal). Veprimet e mësipërme janë kryer në territorin e shqipërisë (ratione loci) dhe në kohë (ratione temporae) përpara se të pandehurit të arrinin në Itali, vend në të cilin ata do të realizonin qëllimin kriminal, shfrytëzimin e të dëmtuarave për prostitucion.

10. Nuk pajtohem me mendimin e shumicës se vepra penale e “Trafikimit të femrave” është vepër penale materiale, që do të thotë se ajo nuk quhet e konsumuar nëse nuk realizohet qëllimi kriminal, shfrytëzimi i prostitucionit. “Trafikimi i femrave” është vepër penale formale, që do të thotë se mjafton kryerja e saj nga ana objektive, në një nga format e parashikuara si rekrutim, transportim, transferim etj, që ajo të quhet e konsumuar dhe subjektet do të përgjigjen penalisht. Të pranojmë të kundërtën, do të thotë

se nëse personi në momentin që kalon kufirin shtetëror heq dorë përfundimisht dhe vullnetarisht nga kryerja e krimit, ai nuk do të përgjigjet penalisht, është një qëndrim që bie ndesh me rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të veprimeve të kryera deri në këtë moment.

11. Si përfundim, nuk ndodhemi përpara parimit të “*ne bis in idem*”, pasi të pandehurit janë gjykuar dhe dënuar në Itali për një vepër penale të konsumuar brenda territorit italian, veprimtaria e së cilës ka filluar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë, për këto veprime ata do të gjykohen sipas ligjit penal shqiptar.

Kryetari: Laurent FUÇIA